



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Gjykata

Numri i lëndës: 2019:228769

Datë: 11.07.2024

Numri i dokumentit: 05928476

AN.nr.41/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, në çështjen juridike të paditëses Sh.B komuna e Vushtrrisë, të cilën me autorizim e përfaqëson S.H, komuna e Vushtrrisë, kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimi e Bujqësisë në Prishtinë, për mos përmbushje të kontratës, duke vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës në mes të Gjykatës Themelore në Mitrovice –Dega në Vushtri- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Për gjykim në këtë çështje juridike është kompetente Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, si gjykatë me kompetencë lëndore dhe territoriale, të cilës t’i dërgohen shkresat e lëndës në kompetencë dhe vendosje.

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet e drejta e ankesës konform nenit 26.3 të LPK-së.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovice –Dega në Vushtri- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktvendimin C.nr.108/18, të datës 31.08.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për vendosje dhe me të njëjtin aktvendim ka vendosur që pas plotfuqishmërisë të këtij aktvendimi, lënda t’i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, si gjykatë kompetente në pikëpamje lëndore. Në bazë të dispozitave të nenit19 dhe nenit 19 të LPK-së.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me aktvendimin A.nr.1370/2024, të datës 14.05.2024, ka hapur konflikt të kompetencës duke mos e pranuar kompetencën lëndore dhe territoriale për të vendosur në këtë çështje juridike, duke theksuar se ky departament nuk është kompetent për trajtimin e padisë në fjalë, duke pasur parasysh ligjin Nr.08/L-15 për Gjykatën Komerciale i cili në nenin 13 par.1 nën par.1.12 ka përcaktuar se : Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar në Dhomat e shkallës së parë dhe Dhomat e shkallës së dytë , në 1.12 kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative. Prandaj duke qenë se në këtë rast procedura është zhvilluar në emër të shoqërisë tretarë Sh.B, B.I si paditës, Gjykata Komerciale, përkatësisht Departamenti për Çështje Administrative konsiderohet kompetente për të vendosur lidhur me këtë lëndë , duke iu referuar nenit 24 par.1 të LPK-së, si dhe nenit 18 par.1 pika 1.3 të Ligjit për Gjykatat.

Gjykata e Apelit e Kosovës, në bazë të nenit 25.1 të LPK-së, si gjykatë e shkallës më e lartë dhe e përbashkët për gjykatat në konflikt, është kompetente për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës midis gjykatave. Po ashtu Gjykata e Apelit në bazë të nenit 18 par. 1 pika 1.3 është kompetente të vendos për konfliktin e kompetencës në mes të Gjykatave Themelore, kështu që në bazë të këtyre dispozitave rrjedh se Gjykata e Apelit ka kompetencë për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës në mes të Gjykatave Themelore, Degëve dhe Departamenteve të tyre të cekura më lart.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se tani për tani për të gjykuar në këtë çështje juridike është kompetente lëndore dhe territoriale Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative. Këtë vlerësim, Gjykata e Apelit e mori pasi që Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, nuk ka vepruar si ne vështrim te nenit 33 të LKA-së për padinë e cila nuk është e plotë, se ka të meta, dhe është e pakuptueshme, që ta ftoj paditësen që brenda afatit prej 8 ditësh ti mënjanoj të metat e padisë me paralajmërim për pasojat që do të lindin nëse nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës. Pra nuk ka nxjerr aktvendim për t’ia kthyer për plotësim paditëses padinë, që ti mënjanoi të metat që janë të tilla që pamundësojnë zhvillimin e procedurës. Kjo gjykatë nga kjo parashtrësë, që nuk përmban kërkesë të qartë dhe petitum të padisë, nuk mund të nxjerr një përmbajtje të saj.

Sepse me dispozitën e nenit 14 të Ligjit Nr.03/L-199 për Gjykatat, (tani nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat), është përcaktuar se: *“Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore të Prishtinës, gjykon dhe vendosë në Konfliktin Administrativ sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështje të tjera të përcaktuara me ligj”*. Meqë në rastin konkret, objekt i kontestit mund të jetë akti administrativ përfundimtar.

Në bazë të nenit 17 dhe 18 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se gjykata sipas detyrës zyrtare, menjëherë pas marrjes së padisë, duhet të konstatojë se a është kompetente për procedimin e çështjes që i është paraqitur, dhe gjatë gjithë procedurës kujdeset nëse zgjidhja e kontestit hyn ose jo në kompetencën gjyqësore.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, të cilës i është dorëzuar padia me shkresa, gjatë shqyrtimit paraprak të parashtrësës kur ka vërejte qartë se padia nuk i përmban elementet e kërkuara me nenin 30 të LKA-së, atëherë me aktvendim të veçantë është dashtë ta thërras paditësen që ta korrigjoj dhe plotësoj, siç parashihet me nenin 33 të LKA-së. Sepse nuk i plotëson kushtet në kuptim të dispozitës, që të veprohet sipas saj. Meqë, Departamenti për Çështje Administrative, i Gjykatës

Themelore në Prishtinë, nuk ka vepruar si në vështrim të dispozitave të lartcekura para se të inicioj procedurën për konflikt kompetence, ngase në shkresat e lëndës ekziston vendimi nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimi e Bujqësisë i datës 14.02.2018 me të cilin akt administrativ është refuzuar ankesa e fermerës Sh.B si e pa bazuar dhe e pa argumentuar, në të cilin vendim është dhënë këshilla juridike se kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të tij në organet kompetente gjyqësore.

Për arsyet e lartcekura, Gjykata e shkallës së parë, në ri procedurë është e obliguar ti shqyrtoi të gjitha parashtrimet e theksuara në këtë aktvendim dhe pas veprimit si në vështrim të nenit 33 të LKA-së, të merr një aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të aktvendimit në bazë të nenit 25 par.1 të LPK-së, e lidhur me nenin 18 par.1 pika 1.3 të Ligjit për Gjykatat, (tani nenit 22 par.1 pika 1.2 të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AN.nr.41/2024, me datë 08.07.2024

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi